



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

*Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr. 18 Tiranë*

*Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814*

Nr. 514/6 Prot.

Tiranë, më 23.11.2016

**V E N D I M**

Nr. 126, datë 23.11.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ  
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 514/1, datë 02.09.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 514 prot., datë 03.08.2016, për disa pretendime të ngritura në lidhje me procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor 2016, për punonjësen \*\*\*\*\* dhe marrjen ndaj saj të masës disiplinore "Mbajtje të 1/3 të pagës së plotë",

**VËREJ SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej nëpunëses \*\*\*\*\*, bazuar në nenin 16, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", me urdhrin nr. 514/1, dt. 02.09.2016, nisi verifikimin e problemeve të pretenduara, në përfundim të të cilit, rezultoi sa më poshtë:

Punonjësja \*\*\*\*\* është nëpunëse civile, me detyrë "Audituese e Dytë", pranë Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në zbatim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i ndryshuar, për këtë punonjëse është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2016, në lidhje me realizimin e objektivave të punës dhe aftësive në kryerjen e detyrave. Ky vlerësim është kryer në datën 15.07.2016 dhe i është njoftuar nëpunëses, në datën 18.07.2015.

Nga përmbajtja e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë, rezulton se për periudhën Janar – Qershor 2016, kjo punonjëse është vlerësuar me nivelin 4, “*Jo kënaqshëm*”. Ky formular është nënshkruar rregullisht nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit, por rezulton që zyrtari kundërfirmues nuk ka pasqyruar mendimin e tij në lidhje me miratimin apo jo të këtij vlerësi.

Njëkohësisht, rezulton se, zyrtari raportues, \*\*\*\*\*, ka nënshkruar gabimisht edhe për zyrtarin autorizues, fakt që gjen pasqyrim dhe në fletën e fundit të formularit, konkretisht në **ndarjen Dh**, “*Rivlerësim nga zyrtari autorizues*”. Nga verifikimi del se kjo ka ndodhur si rrjedhojë e pakujdesisë së treguar nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, e cila në faqen e fundit të printuar të formularit standard, në pozicionin e “*Zyrtarit Autorizues*”, gabimisht, ka shënuar emrin \*\*\*\*\*. Pas konstatimit të kësaj pakujdesie, ky gabim është mënjanuar duke u printuar sërish dhe duke vënë emrin e saktë të zyrtarit autorizues, (*shih shënimin e kryeaudituesit \*\*\*\*\**, në formular: “*Kjo fletë është plotësuar gabim dhe u korrigjuar*”).

Akti i vlerësimit i është komunikuar të interesuarës, e cila megjithëse nuk ka qenë dakord me vlerësimin, ka refuzuar të nënshkruajë, edhe pse i është kërkuar të nënshkruajë me shënimin përkatës, “*nuk jam dakord*”. Fakti i marrjes dijeni, për këtë vlerësim prej ankuseses, del dhe nga përmbajtja e letrës së datës 18.07.2016, me të cilën, sipas pretendimit të saj, ajo i është drejtuar eprorit direkt, \*\*\*\*\*, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, dhe ka kërkuar rivlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2016.

Por, vlerësimi i mësipërm nuk është marrë në rishqyrtim, nga zyrtari autorizues dhe zyrtarët e tjerë pjesëmarrës në procesin e vlerësimit pasi, pretendohet se punonjësjë nuk ka paraqitur ankim dhe se ata nuk kanë dijeni për këtë letër/ ankim. Duke qenë se ankesa në fjalë, sipas deklaramentit të nëpunësës nuk është protokolluar, sjell si pasojë pamundësinë e kësaj të fundit për të vërtetuar se ajo ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj aktit të vlerësimit, që i njihet prej pikës 1, të Kreut V, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, (i ndryshuar me Vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave).

Edhe në përmbajtjen e raportimit të datës 09.09.2016, që zyrtarët raportues e kundërfirmues, pjesëmarrës në këtë proces, kishin paraqitur para eprorëve të tyre, në lidhje me këtë problem, “*Sqarim mbi ndjekjen e procedurave për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.01.2016 deri më 30.06.2016, për audituesen \*\*\*\*\**”, përmendet fakti se nëpunësja \*\*\*\*\* deri në datën 13.09.2016, nuk ka nënshkruar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë dhe nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij akti.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke trajtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e veprimit administrativ të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësës \*\*\*\*\* për periudhën janar – qershor 2016, konstaton faktin se, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) është një institucion i pavarur, i cili kompetencat dhe funksionet e tij i ushtron mbi bazën e ligjit nr. 154/2014, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe të Rregullores së Brendshme të miratuar me vendimin nr. 85, datë 30.06.2015, të Kryetarit të KLSH. Sipas akteve rregullative të mësipërme, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë të këtij institucioni e sidomos strukturave audituese, krahas zbatimit të rregullave të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve*

*civilë*”, i ndryshuar, plotësohet dhe nëpërmjet zbatimit të “*Modularit për Metodologjinë e Vlerësimit*” të veprimtarisë audituese, që mbështetet në rregulloren e brendshme të institucionit, si dhe në urdhrin nr. 04, datë 13.01.2015, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “*Për kriteret e vlerësimit të veprimtarisë audituese, të stafit auditues*”.

Rregullorja e brendshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përmbajtje të saj, përcakton në mënyrë të hollësishtme procedurën që ndiqet për vlerësimin e audituesve, në fund të çdo auditimi, duke përcaktuar fazat në të cilat kalon dhe personat kompetentë për zhvillimin e kësaj procedure. Referuar rregullores, Kryeaudituesi në çdo departament auditimi në bazë të kompetencave të tij ndjek veprimtarinë e audituesve, duke urdhëruar dhe këshilluar grupet e auditimit për realizimin me cilësi dhe efektivitet të auditimeve (faqe 66, e rregullores), kontrollon materialet e auditimit të përpiluara nga audituesit dhe në fund të çdo auditimi bën vlerësimin përkatës.

Konkretisht, në pikën 10, të kapitullit 11.21, të kësaj rregulloreje, përcaktohet shprehimisht që Kryeaudituesi në Departamentin e Auditimit: “*Evidenton dhe regjistroj të dhëna për cilësinë e materialeve të auditimit për çdo auditim të përfunduar dhe evaduar*” dhe në pikën 12, të këtij kapitulli, përcaktohet se: “*Jep mendime dhe bën propozime për përmirësimin e punës së departamentit, të institucionit dhe vlerësimin e punës së audituesve*”.

Gjithashtu, në këtë rregullore, në pikën 13, të Kapitullit 11.5, përcaktohet se Drejtori i Departamentit të Auditimit: “*Jep mendime dhe vlerësime me shkrim në formularin përkatës mbi materialet e auditimit, të paraqitura nga grupet e auditimit të shqyrtuara më parë prej kryeaudituesit*. Këto mendime, së bashku me ato të dhëna nga drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtorit të Përgjithshëm, i kalojnë për vendimmarrje Kryetarit”.

Në procesin e vlerësimit periodik të audituesve në përfundim të auditimit, merr pjesë edhe juristi i Departamentit të Auditimit, i cili në zbatim të pikës 4, të kapitullit 11.25, ndërmjet të tjerave ka si detyrë që: “*Në bashkëpunim me kryeaudituesin jep mendim me shkrim për materialet e auditimit, mbi bazueshmërinë ligjore, trajtimin e shkeljeve, masave dhe detyrave që propozohen dhe ia paraqet drejtorit të departamentit. Ndihton drejtorin e departamentit për plotësimin e formularit të “kontrollit të cilësisë”, si pjesë e dosjes së auditimit*”.

Tërësia e veprimeve të mësipërme, në kuadër të vlerësimit periodik të audituesve, procedurë e cila përfshin vlerësimin e dhënë nga Kryeaudituesi, Drejtor i Departamentit të Auditimit dhe juristi i Departamentit, ndihmojnë në zhvillimin e vlerësimit të rezultateve në punë sipas fazave të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në pikën 12, të Kreut II, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar.

Nisur mbi këtë bazë, pas vlerësimit jo të mirë të performancës në punë, për shkak të nivelit jo të kënaqshëm të produktit të auditimit të nëpunëses \*\*\*\*\*, kryer nga ana e Drejtorit të Departamentit të Auditimit në bashkëpunim me kryeaudituesin e departamentit, në mënyrë periodike në përfundim të çdo auditimi gjatë vitit 2015, drejtuesi i institucionit ka reaguar, fillimisht, me urdhrin nr. 58, datë 30.04.2015, “*Për ulje në gradë auditimi*”, duke vendosur kalimin e kësaj nëpunëseje nga niveli “*Audituese e Lartë*” në nivelin “*Audituese e Parë*”, me kategori page III-a.

Më pas, për të njëjtën arsye, me urdhrin nr. 152, datë 11.12.2015, nga ana e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është vendosur kalimi i kësaj nëpunëseje nga pozicioni “*Auditues i Parë*” në pozicionin “*Auditues i Dytë*”, me kategori page III-b.

Nga verifikimi i akteve të vlerësimit sipas metodologjisë së auditimit, konstatohet se ato janë plotësuar në përputhje me ligjin dhe përmbajnë të gjitha komentet përkatëse në lidhje me vlerësimin përfundimtar për nëpunësen \*\*\*\*\*, arsyet e këtij vlerësimi, si dhe vërejtjet e nevojshme, me qëllim arritjen e rezultateve dhe objektivave më të larta nga nëpunësi civil, komente të cilat gjejnë pasqyrim edhe në formularin standard të vlerësimit të rezultateve në punë të përpiluar për këtë nëpunëse për periudhën Janar - Qershor 2016.

Nga ana tjetër, aktet administrative të përmendura më sipër, (*konkretisht urdhri nr. 58, datë 30.04.2015 dhe urdhri nr. 152, datë 11.12.2015, i Kryetarit*), që përmbajnë qëndrimin konkret, rast pas rasti, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në raport me punën dhe produktin e auditimit të kësaj nëpunëseje, janë akte të nxjerra në përputhje me kompetencat e përcaktuara në nenin 10.3, pika 10, të Rregullores së Brendshme të institucionit. Kjo dispozitë përcakton shprehimisht se: “*Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit vendos për: Emërimin, largimin ndryshimin dhe dhënien e masave disiplinore për Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorin/Drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive, audituesit dhe specialistët në përputhje me kërkesat e ligjit “Për nëpunësin civil”, për **ngritjen apo uljen në kategori të audituesve**; si dhe për punonjësit që trajtohen me Kodin e Punës”.*

Në kuptim të nenit 25, të ligjit nr. 154/2015, “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Kryetari i këtij institucioni është përgjegjës për miratimin e strukturës, organikës dhe emërtimin e funksioneve të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në zbatim të kësaj dispozite, me miratimin e Rregullores së Brendshme nr. 85, datë 30.06.2015, është bërë edhe klasifikimi i pozicioneve të punës, nga e cila rezulton se pozicionet e audituesve pavarësisht emërtimeve specifike kur ndahen në nivele të ndryshme (*Auditues i Lartë; Auditues i Parë dhe Auditues i Dytë*), klasifikohen/njëjtësohen në kategorinë e pozicioneve **të nivelit të ulët drejtues**, duke ndryshuar vetëm nivelet e pagës. Në vazhdimësi, në kuptim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dispozitë e cila bën klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit, ky institucion ka bërë dhe klasifikimin e audituesve sipas klasave dhe kategorisë së pagës (*në Lidhjen nr. 4, Lidhjen nr. 5 dhe Lidhjen nr. 6*), sipas së cilës Audituesi i Lartë dhe Audituesi i Parë i përkasin kategorisë së pagës III-a, ndërsa Audituesi i Dytë, kategorisë së pagës III-b.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se procedura e uljes në gradë, apo e ndryshimit të nivelit të pagës, nuk vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit të posaçëm për shërbimin civil, i cili rregullon procedurat e ngjashme. Ndryshimi i kategorisë së pagës për ankuesen, në rastin konkret nuk ka ardhur si rrjedhojë e marrjes së një mase disiplinore konkrete (*procedurë e cila kërkon respektimin e kërkesave të neneve 57-61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*), por është rezultat i ndryshimit/uljes së gradës, në të njëjtën klasë, brenda të njëjtës kategori, sipas rregullave të posaçme organizative të institucionit.

Interpretimi i dispozitave të mësipërme në raport me faktet e përmendura, përcakton se procedura e ndjekur nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për uljen në gradë auditimi dhe kategori page, është kryer në përputhje me dispozitat e ligjit specifik që rregullon veprimtarinë e institucionit në hetim si dhe Rregullores së Brendshme të tij. Si rrjedhim, kjo procedurë nuk

përbën shkelje të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, gjë e cila shërben për vlerësimin si të pabazuar në ligj, të pretendimit të ankueses, se ulja e nivelit të *pagës (për shkak të uljes në kategori)* është një masë disiplinore dhe mbajtja e saj tej afatit maksimal 6 mujor, që parashikon pika “b”, e nenit 58, të ligjit të sipërcituar, është shkelje e të drejtave të nëpunësit civil.

Sa më sipër, në analizë të dokumenteve shkresore të administruara dhe legjisllacionit në fuqi, përfundimisht çmojë se pretendimi i parashtruar nga nëpunësja \*\*\*\*\*, nëpërmjet kërkesës nr. 514 prot, datë 03.08.2016, për paligjshmëri në zhvillimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor 2016, është i pasaktë dhe i pabazuar në ligj.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, si dhe nenin 16 dhe 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me urdhrin nr. 514/1, datë 02.09.2016, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, në lidhje me disa parregullsi të pretenduara gjatë procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor 2016”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ankuesja \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**